



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura VI**

Sesioni pranveror

**Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi**

Mbledhja nr.10

Prishtinë, më 30.1.2018, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Teuta Haxhiu, Mufera Shinik, Arbërie Nagavci, Adem Mikullovc, Valentina Bunjaku-Rexhepi, Fidan Rekaliu, Nezir Çoçaj, Verica Qeraniq dhe Albulena Balaj-Halimaj.

**Munguan:** Ismajl Kurteshi dhe Abdyl Salihu.

**Përfaqësues të ftuar:** Shyqiri Bytyqi, ministër i MASHT, Arben Dermaku e Alush Istogu nga MASHT-i.

**Përfaqësues të tjerë:** Rron Gjnovci-ORCA, Rinor Qehaja-EDGUARD dhe përfaqësues të medias.

**Stafi mbështetës i Komisionit:** Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

**Mbledhjen e kryesoi, Teuta Haxhiu, zëvendëskryetare e parë e Komisionit.**

**Në këtë mbledhje u propozua ky**

**Rend i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 19.1.2018;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjen Ndërkombëtare në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës (MASHT) dhe Stitching Spark-ut të Holandës (SPARK) mbi mbështetjen e Kolegjit Ndërkombëtar të Biznesit Mitrovica;**
- 4. Raportim i ministrit të MASHT-it në lidhje me gjendjen në Arsimin e Lartë;**
- 5. Të ndryshme.**

Kryesuesja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

**1. Miratimi i rendit të ditës;**

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

**2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 19.1.2018;**

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 19.1.2018, u miratua pa vërejtje.

**3. Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës (MASHT) dhe Stitching Spark-ut të Holandës (SPARK) mbi mbështetjen e Kolegjit Ndërkombëtar të Biznesit Mitrovica;**

**Teuta Haxhiu**, tha se Projektligji nr. 06/L-045 për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës (MASHT) dhe Stitching Spark-ut të Holandës (SPARK) mbi mbështetjen e Kolegjit Ndërkombëtar të Biznesit Mitrovica, iu është shpërndarë deputetëve më 16.1.2018 dhe janë plotësuar afatet ligjore për shqyrtim të tij. Si Komision Funkcional ngarkohemi ta shqyrtojmë të njëjtin dhe Kuvendit t'i paraqesim raport me rekomandime për miratim apo mosmiratim, ndërsa më pas fjala iu dha ministrit Shyqiri Bytyqi, për të paraqitur arsyetimin e projektligjit.

**Shyqiri Bytyqi**, ministër i MASHT-it, tha se Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në bazë të legjislacionit në fuqi ka zhvilluar të gjitha procedurat e parapara për miratim të Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës dhe Stitching "SPARK"-ut të Holandës për mbështetjen e Kolegjit Ndërkombëtar të Biznesit Mitrovica. Qëllimi i miratimit të këtij Projektligji është zhvillimi, rritja e kapacitetit dhe mbështetja e veprimtarisë së Kolegjit Ndërkombëtar të Biznesit Mitrovica, si një kolegji evropian shumetnik në Mitrovicë.

**Teuta Haxhiu**, tha se kjo marrëveshje është e trashëguar nga Qeveria e kaluar dhe shprehu dilemat e saj për këtë projektligj. Ajo tha se ndarja e mjeteve buxhetore prej 3 milion euro për pesë vite për këtë marrëveshje është e papranueshme, duke pasur parasysh edhe deklaratën financiare të Ministrisë së Financave, e cila në vlerësimin e saj thekson se MASHT-i nuk ka planifikuar ndarje buxhetor për zbatim të kësaj marrëveshje. Sipas saj, këto mjete do të ishte më mirë të ndahen për studentët meritore apo edhe për mbështetje për të gjitha institucionet që kanë nevojë për ngritje të cilësisë në arsim.

**Arbërie Nagavci**, tha se ne paraprakisht kemi pranuar një interpretim në lidhje me bazën ligjore të kësaj marrëveshje, e cila është e bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë, që lejohet përkrahja financiare edhe për bartësit privatë të arsimit të lartë, mirëpo, shprehi shqetësimin e saj lidhur me

deklaratat e ministrit për mbyllje të disa universiteteve publike, testimin e studentëve që kanë përfunduar studimet në kolegjet private, kërkoi sqarim lidhur me arsyet se pse ky Kolegj duhet të mbështetet nga buxheti i Republikës së Kosovës me nga gjashtëqind mijë euro (600,000 €) për çdo vit kalendarik, sipas nenit 20 të Ligjit për Arsimit të Lartë, MASHT-i ka mundësi të mbështes bartësit privatë të arsimit të lartë të licencuar dhe akredituar në mbështetje të objektivave të Ministrisë, pra cilat janë objektivat e ministrisë për mbështetje të kësaj marrëveshje. Sa i përket marrëveshjes dhe obligimeve ndërkombëtare, Nagavci tha se si shtet duhet të jemi serioz dhe konsideron se ato duhet respektuar.

**Nezir Çoçaj**, në diskutimin e tij tha se do ta mbështetës projektligjin për ratifikimin e kësaj marrëveshje, duke pasur parasysh se Bashkimi Evropian ka ndihmuar dhe ka ndarë fonde në fusha të caktuara e në veçanti për arsimin. Edhe Ligji për Arsimin e Lartë e lejon mundësinë për të mbështetur edhe bartësit privatë të arsimit të lartë, andaj mbështetja e këtij Kolegji është i një rëndësie të veçantë. Përkundër kësaj kërkon që institucionet e arsimit të lartë të aplikojnë për fonde në Komision Evropian me projekte për mbështetje në hulumtime dhe kërkime shkencore.

**Valentina Bunjaku-Rexhepi**, tha se marrëveshja është adresuar me kohë dhe e kam analizuar në detaje. E mbështes faktin për financim të këtij Kolegji, për shkak të specifikave të regjionit por nuk duhet anashkaluar edhe universitetet tjera të cilat kanë nevojë për mbështetje financiare nga MASHT-i. Do ta mbështes këtë projektligj për ratifikim të kësaj marrëveshje, duke pasur parasysh se në këtë Kolegj regjistrohen studentë të të gjitha komuniteteve.

**Adem Mikullovc**, në diskutimin e tij tha se ka dilemat e tij sa i përket ekzistimit të këtij Kolegji për shkak se kemi institucione të tilla mjaft, andaj nuk do ta përkrahu këtë projektligj.

**Shyqiri Bytyqi**, tha se miratimi i këtij projektligji ka për qëllim mbështetjen e veprimtarisë së Kolegjit Ndërkombëtar të Biznesit Mitrovica, si një kolegj evropian shumetnikë në Mitrovicë i cili synon që të nxjerrë nëpunës civilë të rinj profesionalë dhe udhëheqës biznesi në regjionin e Mitrovicës, të prirur të punojnë në ekupe shumetnike, ta rrisë mundësinë e punësimit përmes programeve studimore me fokus kryesor në praktikën dhe shkathtësitë, ta ndihmojë Kosovën në rrugën e saj drejt integritimit në BE, duke ofruar kurrikula moderne në të bërit biznes me BE-në dhe trajnimin e shërbyesve civilë për integrim në BE. MASHT-i do të sigurojë fonde publike për Kolegjin Ndërkombëtar të Biznesit Mitrovica, në mbështetje të objektivave të Ministrisë të renditura në nenin 2 të kësaj Marrëveshje në vlerë prej së paku 600,000 € (gjashtëqind mijë euro) të buxhetit total vjetor të IBCM-së, në mënyrë të vazhdueshme për çdo vit kalendarik, do të caktohet personi kontaktues për përcjelljen e realizimin e kësaj marrëveshjeje.

**Teuta Haxhiu**, i njoftoi anëtarët e Komisionit në lidhje me një shkresë që i është bashkangjitur projektligjit e që nuk ka të bëjë me marrëveshjen në fjalë, që konsiderohet se është një lëshim teknik.

Pas diskutimeve u hodh në votim Projektligji nr. 06/L-045 për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës (MASHT) dhe Stitching Spark-ut të Holandës (SPARK) mbi mbështetjen e Kolegjit Ndërkombëtar të Biznesit Mitrovica.

Me 6 vota për, 2 abstenime dhe 1 votë kundër, Komisioni vendosi që Kuvendit, t'ia paraqet këtë :

### **R e k o m a n d i m**

Të miratohet Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës (MASHT) dhe Stitching SPARK-ut të Holandës (SPARK mbi mbështetjen e Kolegjit Ndërkombëtar të Biznesit Mitrovica.

#### **4. Raportim i ministrit të MASHT-it në lidhje me gjendjen në Arsimin e Lartë;**

**Teuta Haxhiu**, rreth kësaj pike të rendit të ditës, tha se Komisioni është pajtuar që të diskutohet për gjendjen në Arsimin e Lartë, andaj për këtë çështje është ftuar ministri.

**Shyqiri Bytyqi**, tha se gjendja në arsimin e lartë respektivisht në universitetet publike është e tillë që kërkon një trajtim të veçantë, duke pasur parasysh kushtet që duhet plotësuar një universitet për t'u akredituar dhe faktin se mund të ndodh degradimi i universiteteve në kuptimin e emërtimit sipas rregulloreve të Agjencisë së Akreditimit. Gjendja faktike e këtyre universiteteve është e tillë që nuk përkon me profilizimin e tyre, por kemi të bëjmë me institucione identike në kuptimin e programeve që ofrojnë.

Ai tha se problemet me të cilat ballafaqohen këto universitete, përkojnë me cilësinë e stafit akademik, rangimin e varfër të tyre në platformat e universiteteve publike dhe infrastrukturën e dobët. Për këtë qëllim MASHT-i ka themeluar një grup punues që të bëjë një raport lidhur me fizibilitetin e këtyre universiteteve. Qëllimi i MASHT-it nuk është të shuaj programet ekzistuese të këtyre universiteteve, por ka të bëjë me riorganizimin e tyre në kuptimin e menaxhimit të tyre, në riorganizimin e tyre duke ruajtur kampuset si të tilla me funksionet që kanë.

Gjendjen e tanishme nuk duhet ta tolerojmë pasi baza e cilësisë së arsimit në universitetet tjera publike duhet të jetë të paktën në minimumin e Universitetit të Prishtinës. Sa i përket kolegjeve private, tha se cilësia nuk është e mirë, duhet të vendosim rend në këto kolegje, ndërsa theksoi idenë për mbajtjen e provim shtetëror.

**Arben Dermaku**, këshilltar i ministrit, diskutoi lidhur me punën e grupit punues të MASHT-it, për fizibilitetin e universiteteve publike. Ai tha se çështja e ngritur rreth mundësisë së riorganizimit të universiteteve publike nuk nënkupton mbyllje të tyre apo largim nga puna, por ka të bëjë vetëm me riorganizimin menaxherial, në kuptim të rritjes së cilësisë akademike. Propozimi i parë i grupit punues është që të kemi dy Universitete Publike të Kosovës, një në Prishtinë dhe një në Dukagjin që do të operojnë në formë të kampuseve universitare. Propozim tjetër është që universitetet aktuale të profilizohen sipas specifikave të vendeve ku operojnë. E

përbashkëta e këtyre dy propozimeve është profilizimi dhe riorganizimi i tyre në kuptim të rritjes së cilësisë akademike.

**Valentina Bunjaku-Rexhepi**, tha se është e papranueshme ideja për mbyllje të universiteteve publike dhe ndoshta më shumë ka qenë një keqkuptim medial, sa i përket propozimeve për riorganizim të universiteteve, tha se duke pasur parasysh specifikat e Universitetit të Gjilanit e përkrah propozimin e dytë që ka të bëjë me profilizimin, dhe kërkon që të ndihmohet me staf shtesë për të përmbushur kërkesat e studentëve.

**Nezir Çoçaj**, kërkoj nga ministri që të përkushtohet më shumë në punët që ndikojnë në ngritjen e cilësisë në arsim, rritjen e buxhetit për arsim si dhe rritjen e numrit të stafit akademik, me theks të veçantë për Universitetin e Prizrenit, që aktualisht janë diku 29 veta staf i rregullt dhe pjesa tjetër staf i angazhuar. Është lajm i mirë përmirësimi në rangimin ndërkombëtar të universiteteve publike e kolegjeve private, po ashtu e vlerësoj si pozitive rangimin e Universitetit të Prishtinës pas atij të Tiranës, ndërsa kërkoj nga ministri që të mbaj takime të rregullta me rektorë, në mënyrë që të informohet me punën dhe sfidat që ata ballafaqohen. Në lidhje me prononcimin e ministrit për dy universitete publike dhe ndarjen e tyre në bazë të regjioneve, tha se kjo ide është e papranueshme dhe e tejkalluar.

Çështje tjetër që ngriti ishte buxheti i pamjaftueshëm për hulumtime dhe kërkime shkencore, çështje e lëndëve mësimore në programet Master dhe mbrojtja e temave, çështjen e Agjencisë së Akreditimit si një institucion kyç për MASHT-in, mbështetjen edhe për kolegjet private, zbatimin e Ligjit për Profesionet e Rregulluara që ka të bëjë me themelimin e Agjencisë për Provime Shtetërore, çështjen e disa programeve të paakredituara në universitetet publike si dhe mungesën e bursave për studentë të Universitetit të Prizrenit.

**Fidan Rekalju**, ngriti çështjen e vendimit të padrejtë të Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës për zvogëlimin e bursave nga 600 në 500 euro, dhe kërkoj sqarim nga ministri për veprimet e tij lidhur me këtë vendim.

**Albulena Balaj-Halimaj**, tha se në takimin e Komisionit me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile pjesë e koalicionit për "Integritet dhe Transparencë në UP", jemi informuar për shumë çështje për sa i përket arsimit të lartë.

Sa i përket çështjes së themelimit të universiteteve publike, tha se të gjithë e dimë si janë themeluar ato dhe nuk kemi pasur nevojë që të kemi në çdo qytet nga një universitet dhe shprehu dilemën edhe për sa i përket kolegjeve private, për të cilat tha se nuk e di a i kanë plotësuar kriteret.

Sa i përket propozimeve për riorganizim të universiteteve tha se përkrah propozimin e parë që të kemi dy universitete publike në formë të kampuseve me programet e tyre sipas nevojave të tregut të punës dhe nuk paraqet problem në rast se tre apo katër rektorë mbesin pa punë. Sa i përket buxhetit për shkencë, tha se kërkon sqarim nga ministri lidhur me atë se sa kemi buxhet duhet të bëjmë shkencë apo sa kemi shkencë të ndajmë buxhet. Një çështje tjetër të cilën e ngriti

është çështje e caktimit të mentorëve për tema të diplomave të studentëve, që siç dihet ata presin me vite për të caktuar një mentor.

**Arbërie Nagavci**, në diskutimin e saj ngrit tri çështje të cilat tha se ndërlidhen me gjendjen në arsimin e lartë. Ajo kërkoi sqarim lidhur me mospublikimin e Vendimit të ministrit për emërimin e grupit punues për Fizibilitetin e Universitetit Publik, kush janë anëtarët e këtij grupi dhe cili është profili profesional i tyre dhe çfarë analize do të bëjë grupi punues rreth profilizimit të universiteteve publike.

Çështja tjetër ka të bëjë me obligimin ligjor sipas nenit 7 pika 5 e Ligjit për Arsimin e Lartë për raportim lidhur me shkarkimin e Këshillit Shtetëror të Cilësisë. Nëse shkarkimi i tyre është bërë mbi bazën e shkeljeve që ata kanë bërë, atëherë çfarë është ndërmarrë lidhur me ato shkelje.

Një tjetër çështje për të cilën kërkoi sqarim është anulimi i konkursit të shpallur për çmimet “Shkencëtari i Ri i Vitit” dhe “Shkencëtari i Vitit” të publikuar me 15 nëntor 2017, me arsyetimin se Këshilli Shkencor i MASHT-it ka pasur tetë anëtarë e duhej të kishte shtatë, pra e cilësuar këtë si joligjore dhe kërkoi nga ministri që për çështjet e ngritura të marr përgjigje me shkrim.

**Adem Mikullovc**i, tha se çështja e riorganizimit dhe profilizimit të universiteteve është e domosdoshme dhe duhet të fillohet menjëherë, me këtë rast përmendi rastet nga Fakulteti i Arteve që kanë të bëjnë me staf akademik si dhe lëndë mësimore që nuk kanë të bëjnë me drejtimin përkatës si shembull përmendi lëndën e teknologjisë Informative për aktorët.

**Teuta Haxhiu**, kërkoi sqarim nga ministri, në lidhje me procesin e hartimit të Projektligjit për Arsimin e Lartë dhe sugjeroi që grupi punues gjatë hartimit të tij çështjet kryesore të rregullojë me ligj, në mënyrë që mos të mbetet shumë hapësirë për akte nënligjore.

Haxhiu si çështje tjetër ngriti atë të numrit të mësimeve që kanë përfunduar studimet e tyre në kolegjet private e që është në kundërshtim me ligjin kjo falë një udhëzimi administrativ të nxjerrë nga ish- ministri. Shqetësim tjetër ngriti edhe angazhimin e profesorëve në dy e tre universitete e kolegje njëkohësisht e që sipas informatave që ne kemi nga studentët shumica e ligjëratave mbahen nga asistentët.

Sa i përket buxhetit për shkencë, tha se nuk ka ndarje të mjaftueshme, por edhe ai nuk shfrytëzohet për shkak të kriterëve për aplikim, kurse çështja tjetër ka të bëjë me regjistrimin e studentëve në kolegjet private që vazhdon ende të ndodhë, andaj çfarë ka bërë ministria për ta ndaluar këtë.

**Nezir Çoçaj**, tha se nuk pajtohet me mendimin e koleges nga Nisma se vendi ynë nuk ka pasur nevojë për themelimin të universiteteve publike në qytete të ndryshme. Nuk është çështje se a mbesin pa punë katër apo pesë rektorë, por është shqetësuese ideja për mbylljen e tyre, është mirë që janë themeluar këto universitete dhe iu është dhënë mundësia për studime shumë të rinjve nga Dragashi apo zona e Hasit, të cilët nuk kanë pasur mundësi të studiojnë në Prishtinë.

**Albulena Balaj-Halimaj**, tha se qëndron prapa deklaramit të saj se me rastin e themelimit të universiteteve publike se ka pasur qëllime politike dhe Kosova nuk ka pasur nevojë për të gjitha këto universitete.

**Valentina Bunjaku-Rexhepi**, kërkoi sqarim nga ministri lidhur me idenë për organizimin e provimit shtetëror për studentët që kanë përfunduar studimet e tyre në kolegje private.

**Shyqiri Bytyqi**, në përgjigjen e tij rreth çështjeve të ngritura tha se duhet të kemi një konsensus të përbashkët përtej dallimeve politike për ta nxjerrë arsimin nga kjo gjendje. Tha se ka dhënë ide për riorganizim dhe profilizim të universiteteve publike, por nuk ka marr vendim për to. Alternativa e parë e prezantuar nga grupi punues për riorganizim të universiteteve zgjidh shumë çështje të kuadrit, programeve dhe ngritjes së cilësisë.

Çështje e buxhetit të shkencës pajtohet që është vogël, por tha se kërkesat për mbështetje financiare janë ende me të vogla. Në këtë rast përmendi programin e BE-së për kërkime shkencore Horizont 2020, në të cilin projekt nuk ka pasur të interesuar për të aplikuar me projekte as nga universitetet publike por as nga kolegjet private.

Sa i përket vendimit të Këshillit Drejtues të UP-së për zvogëlim të shumës së bursës për studentë, tha se është anuluar ai vendim dhe është kthyer shuma që ka qenë më parë.

Sa i përket procesit të hartimit të Projektligjit për Arsimin e Lartë, Bytyçi tha se jemi në fazën e diskutimit dhe lidhur e këtë tha se mirëpret pjesëmarrjen e anëtarëve të Komisionit në takimet e grupit punues.

Çështja e regjistrimit të studentëve në kolegje private është një problem me të cilin jemi marrë dhe lidhur me këtë kemi marrë vendim që pas datës 30 shtator, nuk mund të bëhet regjistrimi, për çka edhe janë njoftuar edhe kolegjet private.

Sa i përket anulimit të konkursit për “ Shkencëtari i Ri i Vitit” dhe ”Shkencëtari i Vitit” tha se një gjë e tillë ka ndodhur për shkak se komisioni i formuar ka qenë në kundërshtim me ligjin.

Për sa i përket mbajtjes së provimit shtetëror, tha se do të bëhet sipas Ligjit për Profesionet e Rregulluara dhe do të nënshtrohen të gjithë.

Tjetër çështje që ngriti ishte ajo e studentëve të diplomuar në programe të paakredituara në universitetet publike. Sipas tij, këta studentë pa fajin e tyre sot ballafaqohen me pengesa në vazhdim të studimeve brenda apo jashtë vendit.

## **5. Të ndryshme.**

Në këtë pikë të rendit të ditës nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 13:10.

***E përgatiti:***

***Stafi mbështetës i Komisionit***

Kryetari i Komisionit,  
Ismajl Kurteshi